



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.73, datë 22.12.2025

**“PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURËS SË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR TË SIPËRFAQES PREJ 3.6 HA, EKONOMIA KULLOSORE “TOMORRICË”, SIPËRFAQES PREJ 6.1 HA EKONOMIA PYJORE DËVRI-TËRROVË NË TOTAL 9.7 HA NË PRONËSI PUBLIKE , QË KËRKOHET NGA SHOQËRIA “VËLLEZËRIT HAZISLLARI & QAMO” SHPK, PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT MINERAR NË OBJEKTIN MËLOVË”.**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 22.12.2025, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, nënpika 1.2, neni 27 pika 5, neni 54, gërma “e”, Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Ligjit nr.9693/2007, “Për fondin kullorosor” i ndryshuar, VKM-sp nr.433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/ Bashkive i ndryshuar, VKM-në nr 888 datë 08.06.2016 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakesimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM-në nr.267, datë 27.04.2023, “Për disa ndryshime në VKB-në nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimit dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim /përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike , si dhe prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Udhëzimin nr.1, datë 09.06.2016, “Për rregullat , procedurat e kërkimit , të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullorosor publik”, si dhe shkresën nr.1283 Prot , datë 18.11.2025, me lëndë : Mbi përgatitjen e raportit Teknik dhe dhënien e dakortësisë me Vendim të Këshillit Bashkiak”

VENDOSI:

1. Dhënie e dakortësisë për vijimin e procedurës së heqjes nga fondi pyjor/kullorosor të sipërfaqes prej 3.6 ha Ekonomia Kullosore “Tomorricë”, sipërfaqes prej 6.1 ha Ekonomia Pyjore Dëvri-Tërrovë, në total 9.7 ha, në pronësi publike, që kërkohet nga shoqëria “Vëllezërit Hazisllari& Qamo” Shpk, për zhvillimin e aktivitetit minerar në objektin Mëlovë.

Vendimi u miratua me 13 Vota pro, vota kundër - s’ka , abstenim – s’ka  
Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK  
Elsa PETRITAJ

